



BASHKIA
TIRANË

Drejtuar: Bashkimi i operatorëve ekonomikë “Tower” shpk & “Dricons” shpk

Njësia Bashkiake Nr.2, Rruga “Fadil Rada”, Pallati “Daniela”, Shkalla 2, Kati 3, Ap.9, Nr.pasurie 6/544+2-P, Tiranë & Njësia Bashkiake Nr.7, Rruga “Muhamet Gjollësia”, Pallati 34, Shkalla 3, Kati 2, Ap.29, Tiranë.

Operatori ekonomik “Instituti Dekliada - Alb” shpk;

Njësia Bashkiake nr.5, rruga "Milto Tutulani", Ndërtesa 4, Hyrja 10, Apartamenti 6, 1019, Tiranë

Bashkimi i Operatorëve ekonomik “Studio-Rebus” shpk & “47 EK 79 & Iliriada P.K.S” shpk

Rruga “Sami Frashëri”, Pallati 39, Shkalla 2, Zyra 7 , Tiranë & Bulevardi Zogu i Parë, godinë e re 12-kate, apartamenti 8/3, prane Cirkut Tiranë.

Bashkimi i Operatorëve ekonomik “Infratech” shpk & “Vler Invest” shpk

Rruga “Besim Imami”, Pallati 12-katesh, Kati i 2-te, Nr.13 , Tiranë & Njësia Bashkiake Nr.6, Rruga ‘Shefqet Musaraj’, Pallati nr.52, Kati 7, Ap.nr.29, Mbrapa Universitetit European , Tirane

Operatori ekonomik “Net Group” shpk

Lagjja Paskuqan 1, Rruga Demokracia, Ndërtesa Nr.1, pranë Ahmati Petrol , Paskuqan Kodër, Tiranë

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM
NË MARRËVESHJEN KUADËR**

Lloji i procedurës së prokurimit: “Tender i Kufizuar” me Marrëveshje Kuadër në kuadër të procesit të rindërtimit.

Objekti i kontratës/marrëveshjes kuadër: “Mbikqyrja e punimeve të objektit “Rindërtimi i banesave individuale, brenda dhe jashtë zonave të reja për zhvillim, ndërtimin dhe rikonstruksionin e infrastrukturës publike si dhe çdo ndërhyrje tjetër në funksion të rindërtimit të banesave individuale, jashtë zonave të reja për zhvillim”.

Numri i referencës së procedurës/lotit: REF-59163-05-27-2020.

Fondi / vlera e përafërt e kontratës /marrëveshjes kuadër: 14,271,497 (katërmëdhjetë milion e dyqind e shtatëdhjetë e një mijë e katërqind e nëntëdhjetë e shtatë) lekë pa TVSH.

Kohëzgjatja e kontratës/marrëveshjes kuadër ose afati kohor për ekzekutimin: 24 muaj.

Data e zhvillimit të procedurës së prokurimit: 15.06.2020, ora 11:00

Publikime të mëparshme: (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike: Buletini i Njoftimeve Publike Nr. 31 datë 28.05.2020.

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: X oferta ekonomikisht më e favorshme çmimi më i ulët

Janë skualifikuar Operatorët ekonomik të mëposhtëm:

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

1. Bashkimi i operatorëve ekonomikë “Imes-D” shpk & “IKN” shpk & “Geosat Group” shpk

NUIS:K82430006C & K71828007J & K21624005I

- Bashkimi i operatorëve ekonomikë “Imes-D” shpk & “IKN” shpk & “Geosat” shpk nuk plotëson gjurmën “b” të pikës 2.3.5 të kapacitetit teknik, të kriterëve të vecanta të Dokumentave Standarte të Tenderit: *“Listpagesat e punonjesve të konfirmuara nga autoritetet perkatëse sipas formatit që kerkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën Nëntor 2019 - Prill 2020, shoqëruar me formularët e deklaramit të pagesave për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore”* pasi asnjë nga operatorët ekonomikë pjesë e bashkimit të operatorëve ekonomikë nuk ka paraqitur formularët e deklaramit të pagesave të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore për listpagesat përkatëse, cka rezulton me mospërmbushjen e kësaj kërkesë.

2. Bashkimi i operatorëve ekonomikë “Derbi-E” shpk & “Zenit &Co” shpk

NUIS:K77916947A & K61731002D

- Bashkimi i operatorëve ekonomikë “Derbi E” shpk & “Zenit &Co” shpk nuk plotëson gjurmën “b” të pikës 2.3.5 të kapacitetit teknik, të kriterëve të vecanta të Dokumentave Standarte të Tenderit: *“Listpagesat e punonjesve të konfirmuara nga autoritetet perkatëse sipas formatit që kerkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën Nëntor 2019 - Prill 2020, shoqëruar me formularët e deklaramit të pagesave për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore”* pasi operatori ekonomik “Derbi E” shpk pjesë e bashkimit të operatorëve ekonomikë nuk ka paraqitur formularët e deklaramit të pagesave të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore për listpagesat përkatëse, cka rezulton me mospërmbushjen e kësaj kërkesë.
- Bashkimi i operatorëve ekonomikë “Derbi E” shpk & “Zenit &Co” shpk nuk ka paraqitur një marrëveshje ose kontratë për kryerjen e provave laboratorike cka bie ndesh me kërkesën e përcaktuar në Dokumentat Standarte të Tenderit, kërkesat teknik për kualifikim, konkretisht shënimi: *“Operatori Ekonomik duhet të paraqesë dokumentacion që tregon se disponon apo ka një marrëveshje shërbimi/furnizimi me një laborator të akredituar për testimin e materialeve”*.
- Operatori ekonomik “Derbi E” shpk pjesë e bashkimit të operatorëve ekonomikë “Derbi E” shpk & “Zenit &Co” shpk nuk plotëson kërkesat sipas gjurmave “b”- “dh” të kriterëve të vecanta të kualifikimit pasi nuk ka paraqitur deklaratat e kërkuara. Konkretisht,

operatori ekonomik “Derbi E” shpk nuk ka paraqitur:

b. Deklaratë mbi Konfliktin e Interesit sipas Shtojcës 7;

c. Deklaratë mbi përmbushjen e specifikimeve teknike, sipas Shtojcës 8;

ç. Deklaratë mbi garantimin e zbatueshmërisë së dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës Shtojcës 10;

d. Deklaratë mbi ndërtimet civile dhe industriale sipas shtojcës 11.

dh. Deklaratë mbi kontratat e lidhura ose në proces në kuadër të rindërtimit sipas shtojcës 12.

3. Bashkimi i Operatorëve ekonomik “A & E Engineering” shpk & “M.A.K Studio” shpk

NUIS: K72113010E & L01422017O

- Bashkimi i Operatorëve ekonomik i krijuar nëpërmjet Kontratës për Bashkëpunim Shoqërisht me Nr. 3441 Rep. Nr. 1231 Kol. datë 04.06.2020 nuk ka përcaktuar **përqindjen e pjesëmarrjes në shërbim.**
- Referuar Kreut VIII, Nenit 74, pika 2 e pika 3 të VKM-së Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar) parashikohet se: “2. Para dorëzimit të ofertës, bashkimi duhet të krijohet zyrtarisht, me një marrëveshje të noterizuar, ku të përcaktohen përfaqësuesi i grupit, përqindja e pjesëmarrjes së punës/shërbimit /furnizimit dhe elementet konkrete, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi. Pas krijimit të bashkimit të operatorëve ekonomikë, anëtarët e bashkimit caktojnë me prokurë përfaqësuesin e tyre për dorëzimin e ofertës. Kjo marrëveshje e shkruar dhe prokura duhet të dërgohen së bashku me kualifikimet dhe ofertën ekonomike, e cila duhet të nënshkruhet nga përfaqësuesi. Përfaqësuesi duhet të bëjë edhe sigurimin e ofertës, nëse kërkohet, duke specifikuar pjesëmarrjen në bashkimin e operatorëve ekonomikë. Në rast se bashkimi i operatorëve ekonomikë shpallet fitues, kontrata duhet të nënshkruhet nga secili prej anëtarëve të këtij bashkimi.3. Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat ligjore, të parashikuara në nenin 45 të LPP-së dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, kushti i përcaktuar në shkronjën “a”, të pikës 6, të nenit 26, të këtyre rregullave, plotësohet nga anëtari, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontrata të ngjashme, në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.”
- Për sa më lart, mospërcaktimi i përqindjes së pjesëmarrjes në shërbim, e bën të pamundur vlerësimin e kërkesave ekonomike, financiare, profesionale dhe teknike të Bashkimit të Operatorëve ekonomik “A & E Engineering” shpk & “M.A.K. Studio” shpk.

4. Operatori ekonomik “6D-Plan” shpk NUIS: L62717405H

- Shoqëria “6D-Plan” shpk nuk ka paraqitur Sigurim oferte, çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, pika 1, gërma “a”.

- Referuar Shtojces 12, Operatori ekonomik “6D-Plan” shpk nuk ka deklaruar si kontrate pune ne proces në kuadër të rindërtimit objektin: “Aktekspertizën e thelluar për objektet e dëmtuara nga tërmeti i datës 26.11.2019, të klasifikuara sipas shkallës së dëmtimit DS 4 dhe DS 5, në Njësinë Administrative Nr.5 dhe Njësinë Administrative Nr.9”,çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, pika 1, gërma “dh”.
- Referuar Deklaratës mbi stafin inxhinierik, rezulton se Shoqëria “6D-Plan” shpk ka deklaruar si *Inxhinier Elektrik Z. Besnik Maxhelaku* (për të cilin ka paraqitur dokumentacion të rregullt), si dhe *Z. Elton Qirko* (për të cilin nuk ka paraqitur CV). Për sa më lart, Operatori ekonomik, nuk plotëson DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 2.3.3.
- Listpagesat e paraqitura nga shoqëria “6D-Plan” shpk për periudhën Nëntor 2019-Prill 2020, nuk janë të shoqëruara me FDP, çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 2.3.5, gërma “b”.

5.Bashkimi i operatorëve ekonomikë “Archispace” shpk & “GB Civil Engineering” shpk NUIS: L42403012A & L51825011V

- Bashkimi I operatorëve ekonomikë “Archispace” shpk & “GB Civil Engineering” shpk nuk plotëson pikën 1/a të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit, DST, ku citohet se: *“Sigurim oferte 2 %,sipas Shtojcës 5”*, pasi nuk ka paraqitur sigurimin e ofertës sipas Shtojcës 5.
- Operatori ekonomik “GB Civil Engineering” shpk nuk plotëson pikën 2.2/a të Kapacitetit Ekonomik dhe Financiar, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, DST, ku citohet se : *“Xhiro mesatare e realizuar nga Operatori Ekonomik gjate tre viteve te fundit (2017, 2018, 2019) duhet te mos jete me e vogel se 40 % fondit limit. Per te vertetuar plotesimin e ketij kushti Operatori Ekonomik duhet te paraqese nje vërtetim nga autoriteti përgjegjës për xhiron vjetore të realizuar në 3 (tre) vitet e fundit”*, pasi nuk e ka paraqitur Vërtetimin për xhiron vjetore të realizuar në 3 (tre) vitet e fundit.
- Bashkimi I operatorëve ekonomikë “Archispace” shpk & “GB Civil Engineering” shpk nuk plotëson pikën 2.3.3 të Kapacitetit Teknik, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, DST, ku citohet se: *“Stafi kryesor i inxhinierëve të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit është.....2 (dy) Arkitekt me përvojë pune jo me pak se 5 (pesë) vjet”*, pasi ka paraqitur dokumentacionin e kërkuar vetëm për 1 arkitekt, konkretisht për T.L., referuar listës së stafit të deklaruar, ndërsa për arkitektin E.D nuk është paraqitur asnjë dokumentacion.Po ashtu ka paraqitur dokumentacion për arkitektët R.P dhe G.K, por këta të fundit nuk janë të deklaruar te lista e stafit, fakt që ngre dyshime për angazhimin e tyre në procedura të tjera prokurimi.
- Operatori ekonomik “GB Civil Engineering” shpk nuk plotëson pikën 2.3.5/a të Kapacitetit Teknik, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, DST, ku citohet se : *“Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj; per periudhen Nëntor 2019 - Prill 2020”*, pasi nuk e ka paraqitur këtë Vërtetim.
- Bashkimi I operatorëve ekonomikë “Archispace” shpk & “GB Civil Engineering” shpk nuk plotëson pikën 2.3.5/b të Kapacitetit Teknik, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, DST, ku citohet se: *“Listpagesat e punonjesve te konfirmuara nga autoritetet perkatese sipas formatit qe kerkohet nga legjislacioni ne fuqi per periudhen Nëntor 2019 - Prill 2020, shoqëruar me formularet e deklarimit te pagesave për sigurimet shoqërore dhe shendetesore”*, pasi nuk kanë paraqitur formularët e deklarimit të pagesave për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore.
- Operatori ekonomik “GB Civil Engineering” shpk nuk plotëson pikën 2.3.10 të Kapacitetit Teknik, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, DST, ku citohet se : *“Operatori*

ekonomik duhet paraqesë me anë të një deklaratë listën e personelit kryesor të nevojshëm për të zbatuar objektin dhe CV të shoqërisë për punët e realizuara gjatë aktivitetit të saj”, pasi nuk ka paraqitur CV-në e shoqërisë.

- Operatori ekonomik “Archispace” shpk nuk plotëson pikën 2.3.10 të Kapacitetit Teknik, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, DST, ku citohet se : *“Operatori ekonomik duhet paraqesë me anë të një deklaratë listën e personelit kryesor të nevojshëm për të zbatuar objektin dhe CV të shoqërisë për punët e realizuara gjatë aktivitetit të saj”,* pasi ka paraqitur CV-në në gjuhë të huaj (anglisht) të papërkthyer në gjuhën shqipe, çka bie në kundërshtim me përcaktimin e DST, ku citohet se : *“Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentat në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe”.*

6. Bashkimi i operatorëve ekonomikë “Gjeokonsult&Co” shpk & “ITM” shpk NUIS: K91810005U & L42303016G

- Bashkimi i operatorëve ekonomikë “Gjeokonsult&CO” shpk & “ITM” shpk nuk plotëson pikën 1/a të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit, DST, ku citohet se: *“Sigurim oferte 2 %, sipas Shtojcës 5”*, pasi nuk ka paraqitur sigurimin e ofertës sipas Shtojcës 5.
- Bashkimi I operatorëve ekonomikë “Gjeokonsult&CO” shpk & “ITM” shpk nuk plotëson pikën 2.3.3 të Kapacitetit Teknik, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, DST, ku citohet se: *“Stafi kryesor i inxhinierëve të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit është.....2 (dy) Arkitekt me përvojë pune jo me pak se 5 (pesë) vjet”,* pasi janë deklaruar 3 arkitektë, referuar listës së stafit të paraqitur, por punonjësja L.Z disponon diplomë me titull “Inxhinier Ndërtimi”, dhe punonjësi A.S disponon diplomë me titull “Planifikim dhe Menaxhim Urban “ për rrjedhojë nuk janë arkitektë.
- Bashkimi I operatorëve ekonomikë “Gjeokonsult&CO” shpk & “ITM” shpk nuk plotëson pikën 2.3.5/b të Kapacitetit Teknik, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, DST, ku citohet se: *“Listpagesat e punonjesve të konfirmuara nga autoritetet përkatëse sipas formatit që kerkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën Nëntor 2019 - Prill 2020, shoqëruar me formularët e deklaramit të pagesave për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore”,* pasi nuk kanë paraqitur formularët e deklaramit të pagesave për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore.

7. Operatori ekonomik “Illyrian Consulting Engineers” shpk NUIS: K61814023M

- Operatori ekonomik “Illyrian Consulting Engineers” shpk nuk plotëson gërmën “b” të pikës 2.3.5 të kapacitetit teknik, të kriterëve të veçanta të Dokumentave Standarte të Tenderit: *“Listpagesat e punonjesve të konfirmuara nga autoritetet përkatëse sipas formatit që kerkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën Nëntor 2019 - Prill 2020, shoqëruar me formularët e deklaramit të pagesave për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore”* pasi nuk janë paraqitur formularët e deklaramit të pagesave të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore për listpagesat përkatëse, cka rezulton me mospërbushjen e kësaj kërkesë.
- Operatori ekonomik “Illyrian Consulting Engineers” shpk nuk plotëson pikën 1/a të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit, DST, ku citohet se: *“Sigurim oferte 2 %, sipas Shtojcës 5”*, pasi sigurimi i ofertës është paraqitur me një objekt prokurimi për një

insitucion tjetër, konkretisht Fondin Shqiptar të Zhvillimit, dhe jo për Autoritetin Prokurues, Bashkia Tiranë.

- Operatori ekonomik “Illyrian Consulting Engineers” shpk nuk plotëson pikën 2.3.8 të kapacitetit teknik, të kriterëve të vecanta të kualifikimit të Dokumentave Standarte të Tenderit: *”Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë Çertifikatë OHSAS 18001-2007 (e vlefshme) lëshuar nga institucione të akredituara për këtë qëllim me objekt: supervizion rrugësh dhe ndërtesa civile.....”* pasi certifikata OHSAS 1008-2007 është paraqitur e pavlefshme, afati i vlefshmërisë ka përfunduar në datë 12.07.2019, cka rezulton në pospërmbushjen e këtij kriteri.
- Operatori ekonomik “Illyrian Consulting Engineers” shpk nuk plotëson kushtin e përcaktuar në Dokumentat Standarte të Tenderit, kapaciteti teknik ku citohet se: *”Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim”* pasi rezulton se Diploma e Ing Ndertimit P.B, Diploma e Ing Ndertimit E.K , Diploma e Ing Mekanik N.B janë paraqitur fotokopje të pashoqëruar me vërtetimin e noterizimit për njësimin e fotokopjes me kopjen origjinale.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se janë identifikuar si operatorë ekonomikë të suksesshëm për lidhjen e marrëveshjes kuadër:

1. Bashkimi i operatorëve ekonomikë “Tower” shpk & “Dricons” shpk
2. Operatori ekonomik “Instituti Dekliada” shpk
3. Bashkimi i Operatorëve ekonomikë “Sudio-Rebus” shpk & “47 EK 79 & Iliriada P.K.S” shpk
4. Bashkimi I operatorëve ekonomikë “Infratech” shpk & “Vler Invest” shpk
5. Operatori ekonomik “Net Group” shpk

Shënim: Referuar VKM nr.199, datë 04.03.2020 “Për miratimin e dokumenteve standarde të procedurës së prokurimit, të kriterëve të vlerësimit të ofertës fituese kushteve të marrëveshjes kuadër dhe të kontratës për procesin e rindërtimit”, kualifikimi i ofertuesëve në fazën e parë, nuk është me pikë.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqiteni pranë Bashkisë së Tiranës, Sheshi Skënderbej, Nd. 2, Kodi Postar 1001, Tiranë, brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi për të lidhur draft marrëveshjen.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 22.06.2020

Gjatë afatit ligjor për pritjen e ankesave nga shoqëritë pjesëmarrëse në tender në mbështetje të Aktit Normativ Nr.9, datë 16.12.2019 “Për përballimin e pasojave të fatkeqësive natyrores”, Neni 42, pika 10, nuk është paraqitur asnjë ankesë.